

KUVENDI I KOSOVËS SKUPŠTINA E KOSOVO ASSEMBLY OF KOSOVO			
04.08.2021			
03	47	1469	7



KUVENDI I KOSOVËS SECRETARIA	SKUPŠTINA E KOSOVO SECRETARIAT	ASSEMBLY OF KOSOVO SECRETARIAT
Nr. I265/2125		
Dt. 04.08 2021		
Prishtinë - Pristina		

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm	<b>DATE DATUM DATE</b>	03.08.2021
		Reference	01/08/ZS/21
<b>NGA / OD / FROM</b>	Ismet Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	Plani i veprimit		

I nderuar z. Morina,

Bashkëngjitur kësaj shkrese ju dërgoj Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, për Pasqyrat Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Me respekt,

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**

**TË DHËNA NË RAPORTIN E AUDITIMIT NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NË PASQYRAT  
VJETORE FINANCIARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2020**

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1	Gjetjet dhe rekomandimet	<p>Sipas nenit 47.40 të UOPP, një kontratë duhet të ekzekutohet në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe planin e menaxhimit të kontratës. Sipas nenit 22.4 të kontratës së nënshkruar në mes Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK) dhe OE furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar, do të refuzohen. Ndërsa neni 27 i po të njëjtës kontratë specifikon se në cilat situata autoriteti kontraktues mund ta ndërpresë kontratën.</p> <p>Më 24.06.2015, KRK kishte lidhur kontratë për Liferimin, testimin dhe implementimin në tërësi të sistemit me pajisje portative (mobile) për qasje dhe punë në distancë për nevoja të</p>	<p>Sekretari i përgjithshëm duhet të kërkoj nga operatori ekonomik dorëzimin e të gjitha pajisjeve të kontraktuara, si dhe të forcoj kontrollet lidhur me pranimin dhe vlerësimin me kohë të karakteristikave teknike të pajisjeve/mallrave të kontraktuara.</p>	<p>Në momentin e ekzekutimit të pagesës nga ana e Thesarit të shtetit është kërkuar nga OE dorëzimi i pajisjeve. Në vitin 2020 nga Kuvendi janë pranuar 106 pajisje, kanë mbetur edhe 24 copë pa u dorëzuar nga OE. Kuvendi do të kërkoj në vazhdimësi që OE ti dorëzoj edhe pajisjet e mbetura pa u dorëzuar (sot datë 03.08.2021, përmes email-it, i është dërguar</p>	Administrata e Kuvendit	2021 dhe në vazhdimësi	

	<p>deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Operatori ekonomik ia kishte dërguar pajisjet e kontraktuara Kuvendit më 03.07.20115, dhe komisioni i pranimit dhe menaxheri i kontratës kishin bërë raportin e pranimit të pajisjeve, me vërejtjen se pajisjet e dërguara nuk i përmbushin kërkesat e kontratës. Më 23.07.2015 nga operatori ishte kërkuar që ti tërheqë pajisjet.</p> <p>Operatori nuk i ishte përgjigjur në kërkesat e autoritetit kontraktues, dhe nga këto arsye, më 21.08.2015 kishte ardhur deri te ndërprerja e njëanshme e kontratës nga ana e KRK. Më 30.09.2016, KRK ia kishte kthyer të gjitha pajisjet e pranuar kontraktorit. Për shkak të mospajtimeve në mes palëve kontraktori kishte paditur KRK-në dhe kishte fituar kontestin gjyqësor në vitin 2020. Përkundër ankesave të KRK në tri instanca gjyqësore, përpjekjet kishin rezultuar të pa suksesshme, dhe kontestin gjyqësor e kishte fituar OE.</p>		<p>Operatorit Ekonomik kërkesa për dorëzimin e pajisjeve në administratën e Kuvendit)</p> <p>Kuvendi do të përdor edhe mjete tjera juridike për ti kthyer pajisjet apo vlerën e tyre nëse Operatori Ekonomik nuk i dorëzon pajisjet. Padia nga Kuvendi dorëzuar ne Gjykatë 27.07.2020</p>			
--	---	--	---	--	--	--

	<p>Gjatë vitit me dt. 08.12.2020 Vendimin gjyqësor, kontraktori e kishte dërguar në Thesar për ekzekutim të pagesës, dhe Thesari bazuar në nenin 40 të LMFPP, kishte ekzekutuar pagesën në vlerë prej 130,740€. Prej shumës së paguar, borgjit kryesor ishte 87,960€ interesi 42,780€ dhe shpenzimet tjera gjyqësore 3,445€.</p> <p>Pas pagesave të kryera nga Thesari, operatori ia kishte dorëzuar Kuvendit shumicën e pajisjeve të kontraktuara, por jo të gjitha.</p> <p>Në ndërkohë, pasi që kishte humbur kontestin gjyqësor, Kuvendi më 27 korrik 2020 kishte ushtruar padi gjyqësore në Gjykatën Themelore, ndaj operatorit për pasurim të pa bazë, ku kërkohet që pajisjet e kontraktuara ti dorëzohen nga ana e operatorit, por kontesti ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata.</p>					
2	<p>Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në</p>	<p>Sekretari i përgjithshëm duhet të forcoj kontrollin në procesin e vlerësimit të ofertave, në</p>	<p>Do të kërkohet nga Komisionet përkatëse të vlerësimit të tenderëve</p>	<p>Drejtori i prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit</p>	<p>2021 dhe në vazhdimësi</p>	

		<p>përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosje të tenderit. Ndërsa te neni 9.1 dhe 9.2 i dosjes së tenderit, njëra prej kërkesave ishte, dëshmi (kontrata e punës) për përvojën e punës (së paku 3 vjet) në lëmin përkatës.</p> <p>Në projekti Renovimi i ndërtesës- Punët e paparashikuara në projektin kryesor në vlerë 51,780€, OE për inxhinierin e diplomuar të makinerisë në vend të kontratës kishte ofruar një referencë e cila nuk ofronte dëshmi për periudhën e përvojës së kërkuar. Bazuar në këtë, ne kemi vërejtur se nuk janë përmbushur kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, për të cilat komisioni i vlerësimit të ofertave kishte vlerësuar si të përgjegjshëm duke rekomanduar nënshkrimin e kontratës.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni me rastin e shqyrtimit të ofertave kishte konsideruar se dokumentet e ofruara janë të mjaftueshme dhe</p>	<p>mënyrë që për zgjedhja e fituesve bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosje të tenderit.</p>	<p>vlerësojnë me profesionalizëm duke u bazuar në legjislacionin përkatës të prokurimit si dhe të shtjerrin të gjitha mundësitë ligjore për procesin e vlerësimit.</p> <p>Drejtori i Drejtorisë për Prokurim nënshkruan kontratën vetëm pasi të bëjë vlerësimet e nevojshme në rekomandimin e komisionit për vlerësim dhe atë në pajtim me Ligjin për prokurimin publik dhe Udhëzuesin OP për prokurim publik.</p>			
--	--	--	---	--	--	--	--

		plotësojnë      kërkesat      e					
		përshatshmërisë.					



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

Sekretari i përgjithshëm i Kuvendit

Në bazë të nenit 80, paragrafi 3, të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 7 të Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04- V-396, të datës 5 shtator 2013, mori këtë

**V E N D I M**

- I. Formohet Komisioni për adresimin dhe implementimin e Rekomandimeve të dala nga Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, në këtë përbërje:
  1. Istret Azemi, kryesues
  2. Xhemail Halili, anëtar
  3. Adnan Boshnjaku, anëtar dhe
  4. Vullnet kabashi, anëtar
- II. Komisioni nga pika I. e këtij Vendimi, çdo 3 (tre) muaj duhet të përgatis një Informatë për adresimin – implementimin e Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit

Prishtinë, më 03 Gusht 2021

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit

**Vendimi u dërgohet:**  
-Anëtarëve të Komisionit dhe  
-Arkivit të Kuvendit

Ismet Krasniqi